

## SKEDA E GJYKIMIT NË TRE SHKALLË

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Andi ÇELIKU** - Kryesues

**Arjana FULLANI** - Anëtar

**Medi BICI** - Anëtar

ne dhomën e këshillimit te datës 27.09.2016, mori ne shqyrtim çështjen administrative, qe i përket:

**PALË PADITËSE:** **Florika Bare**

**PALË E PADITUR:** **Drejtoria Shëndetit Publik Mallakastër**

**OBJEKTI:** *Detyrimin e palës se paditur te me dëmshpërbleje me 12 paga mujore për zgjidhje te kontratës pa shkaqe te arsyeshme.*  
*Detyrimin e palës se paditur te me paguaje 3 paga mujore për shkak te mosrespektimit te afatit te njoftimit.*  
*Detyrimin e palës se paditur te me paguaje 2 paga mujore për shkak te mosrespektimit procedurës se zgjidhjes se kontratës se punës.*  
*Detyrimin e palës se paditur te me paguaje shpërblim për vjetërsi ne pune gjithsej 15 muaj page.*

**BAZA LIGJORE:** *Nenet 153 te K.Pr.Civile, Neni, 143, 144, 145,146/2.3 te Kodit te Punës.*

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier** me vendimin nr 896, date 15.05. 2013 ka vendosur:

Pranimin pjesërisht te padisë se palës paditëse Florika Baraj.

Detyrimin e te paditurit Drejtoria e Shëndetit Publik Mallakastër, te dëmshpërbleje paditësen Florika Baraj, me pagën e 11 (njëmbëdhjete) muajve pune, si dëmshpërblim për “zgjidhjen e menjëhershme te pajustificuar te marrëdhënies se punës”.

Detyrimin e te paditurit Drejtoria e Shëndetit Publik Mallakastër, te dëmshpërbleje paditësen Florika Baraj, me pagën e 2 (dy) muajve pune, për “mosrespektimin e procedurës se zgjidhjes se marrëdhënies se punës”, parashikuar nga neni 144/5 i Kodit te Punës.

Detyrimin e te paditurit Drejtoria e Shëndetit Publik Mallakastër, te dëmshpërbleje paditësen Florika Baraj, me pagën e 3 (tre) muajve pune për “mosrespektimin e afatit te njoftimit te zgjidhjes se marrëdhënies se punës”, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit te Punës.

Detyrimin e te paditurit Drejtoria e Shëndetit Publik Mallakastër te dëmshpërbleje paditësen Florika Baraj pagën e 14.5 (katërmbëdhjete pike pese) muajve, për “vjetërsi ne pune”, parashikuar nga neni 145/2 i Kodit te Punës.

Paga mujore për paditësen Florika Baraj llogaritet ne masën 34.660 (tridhjete e katër mije e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) leke ne muaj.

Shpenzimet gjyqësore, procedurale dhe për përfaqësues te palës paditëse I ngarkohen palës se paditur.

Kundër këtij vendimi mund te behet ankim pranë Gjykatës se Apelit Vlore, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes se këtij vendimi.

**Gjykata e Apelit Vlore** me vendimin nr 727, datë 19.11.2013 ka vendosur:

Lënen ne fuqinë te vendimit nr. 896, date 15.05. 2013 te Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Fier

Kolegji Administrativ i Gjykatës se Larte, duke u bazuar në nenin 63 të Ligjit nr.49, datë 03.05.2012 të “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”.

### V E N D O S I

Prishjen e vendimit me nr.727 datë 19.11.2013, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Tiranë, më 27.09.2016

Nr. 31003-00487-00-2014 Regj.Themeltar

Nr. 00-2016- 3083 Vendimit (474)